



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 nën d. nenit 17 paragrafi 1 nën c) dhe nën e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, nenit 10 nën pikën 4, dhe 16 pika 7 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-të të rregullt, të mbajtur më 25.09.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

Vënien në Diskutim Publik të Ndryshimeve dhe Plotësimeve të
Planit Zhvillimor Komunal 2014-2021 për ridestinimin e dy parcelave

I

Lëshohet në Diskutim Publik:

Ndryshimet dhe Plotësimet e Planit Zhvillimor Komunal 2014-2021 për ridestinimin e dy parcelave:

Në ZK Këpuz-pronë shoqërore e KK-Klinë, me kulturë kullos, pjesë e parcelës 279-0, në sipërfaqe prej 0.10.00 ha, që të ridestinohet në tokë ndërtimore.

Në ZK Deiq-pronë shoqërore me kulturë rrugë, pjesë e parcelës kadastrale, Nr.100-0 në sipërfaqe prej 2115m katrorë (0.21.15 ha), që të ridestinohet në tokë ndërtimore.

II

Ndryshimet dhe plotësimet e PZHK, si në pikën 1 të këtij Vendimi lëshohet në Diskutim Publik 15 ditë prej ditës së shpalljes në tabelën e shpalljeve.

III

Brenda 15 ditëve të diskutimit publik të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës, personat fizikë dhe juridikë dhe të gjithë të interesuarit mund të marrin të dhëna për ndryshime dhe plotësime të PZHK në Zyrën Ligjore në objektin e Komunës. Po ashtu, vërejtjet dhe sugjerimet me shkrim mund të dorëzohen tek kjo zyrë.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL në bazë të nenit 81 të LVL.

V

Vendimi është transparent përmes: Tabelës së shpalljeve, Zyrës për Informim, Zyrës Ligjore dhe Radio- "ALBA".

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01 Nr. 06-5363/2015

Klinë, më 25.09. /2015



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi